



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*



**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

**AGJENCIONI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË KOSOVËS/  
INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS**



**BULETINI**  
**HIDRO- KLIMATOLOGJIK**

**TREMUJORI I TRETË 2016, Nr.3**

**Prishtinë, 2016**

I nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që përmes buletinit hidro-klimatologjik të ju ofrojmë mundësinë që të keni qasje në informacionet për gjendjen hidrologjike dhe klimatologjike gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016. Informacionet e dhëna në këtë bulletin janë kontribut nga aktivitetet që ka zhvilluar Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës, përgjegjësi e të cilit është monitorimi i dukurive dhe elementeve hidrologjike dhe meteorologjike dhe elementeve tjera që ndërlidhen me këtë veprimtari.

Për publikimin e këtij buletini ka qenë një shtytje që të punohët në mënyrë që të arrihet informim më cilësor dhe efikas rreth elementeve dhe dukurive hidrologjike, klimatologjike dhe dukurive ekstreme të motit.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është që të sjellim para jush informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike , meteorologjike dhe klimatologjike, në mënyrë që të ndihmojë lexuesit, institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.

Shpresojmë se ky bulletin do të bëhet një burim i rëndësishëm për t'ju ofruar informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike dhe klimatologjike në Kosovë.

**Dr.sci. Ilir Morina**, Kryeshef Ekzekutiv i  
Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

.....

**Ing/Msc. Letafete Latifi** , Drejtore e Institutit  
Hidrometeorologjik të Kosovës

.....

## PARATHËNIE

Hartimi i Buletinit Hidrologjik dhe Klimatologjik është i bazuar në të dhënat e mbledhura nga monitorimi hidrologjik dhe meteorologjik në Kosovë gjatë periudhes 01 Korrik - 30 Shtatorë 2016, realizuar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovë .

Në buletin hidrologjik dhe klimatologjik është pasqyruar gjendja hidrologjike, klimatologjike dhe rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit, janë dhënë fakte nga tereni mbi nivelet e ujrave në lumenjtë e Kosovës, sasia e reshjeve dhe indeksi i standardizimit të reshjeve(SPI) si dhe fakte mbi gjendjen klimatike që përfshinë temperaturat mesatare, minimale dhe maksimale të mesatareve mujore , orët me shkëlqim të diellit dhe ditët me reshje shiu gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016. Janë dhënë informacione mbi rastet e paraqitjes së dukurive ekstreme të motit në Kosovë dhe zonat e përfshira me dukuri ekstreme të motit gjatë periudhës për të cilën referohemi në këtë buletin.

Qellimi i këtij buletini është që të mbajë të informuar me të dhënat më të reja institucionet qeveritare dhe joqeveritare për gjendjen hidrologjike në Kosovë, kushtet klimatike dhe dukuritë ekstreme në mënyrë që institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.

## HIDROMETEOROLOGJIA E KOSOVËS GJATË PERIUDHËS 01 KORRIK- 30 SHTATOR

### GJENDJA HIDROLOGJIKE NË KOSOVË

Gjendja hidrologjike e lumenjëve të Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes Rrjetit të Monitorimit Hidrologjik.

Rrjeti i monitorimit hidrologjik në Kosovë, është i dizajnuar në atë mënyrë, që duke u bazuar në karakteristikat e florës, topografisë, relievit, klimës, etj është bërë vendosja e stacioneve hidrometrike, qëllimi i të cilëve është që në hapësirë dhe kohë, të paraqesin treguesit sasiorë, të njërës prej resurseve më të rëndësishme siç është uji. Rrjeti aktual monitorues, përbëhet prej 27 stacioneve hidrometrike (hartat), të cilët janë të shtrirë në të gjitha pellgjet ujëmbledhëse dhe në bazë të lartësisë mbidetare shtrirja e tyre përfshinë nivelet e larta, të mesme dhe ultësirat.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës gjatë periudhës: korrik – gusht - shtator të vitit 2016 ka monitoruar kushtet hidrologjike në pellgjet lumore të Kosovës, në bazë të specifikave dhe planit dinamikë të përgatitur dhe aprovuar paraprakisht.



*Harta1. Rrjeti i stacioneve hidrometrike të Kosovës*

Në të gjitha profilet hidrometrike, regjistrimi i niveleve të ujit është bërë pandërprerë, me anë të sensorëve automatik. Ndërsa në 7 stacione të cilat përfaqësojnë lumenjtë kryesorë të Kosovës, në pikat dalëse të tyre nga territori i vendit në vendet fqinje, janë të vendosura stacionet automatike me qasje në kohë reale, të cilat e bëjnë regjistrimin, ruajtjen dhe transferimin e informacioneve në çdo kohë në serverin qendrorë (shih tab.1) i cili ndodhet në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës në Prishtinë


**Tabela 1. Intervali i regjistrimit të niveleve dhe mënyra e transferimit të të dhënave**

<i>Nr</i>	<i>Stacioni</i>	<i>Intervali</i>	<i>Frekuenca</i>	<i>Sistemi</i>	<i>Transferimi i të dhënave</i>
3	Gryke	15 min	96	Senzor	GPRS <sup>1</sup>
7	Kepuz	15 min	96	Senzor	GPRS
10	Gjonaj	15 min	96	Senzor	GPRS
15	Nedakovc	15 min	96	Senzor	GPRS
20	Leposaviq	15 min	96	Senzor	GPRS
21	Konqul	15 min	96	Senzor	GPRS
26	Hani I Elezit	15 min	96	Senzor	GPRS
1	Berkove	1 h	24	Senzor	Analoge
2	Drelaj	1 h	24	Senzor	Analoge
4	Kline	1 h	24	Senzor	Analoge
5	Mirush	1 h	24	Senzor	Analoge
6	Deqan	1 h	24	Senzor	Analoge
8	Gjakove	1 h	24	Senzor	Analoge
9	Piran	1 h	24	Senzor	Analoge
11	Prizren	1 h	24	Senzor	Analoge
13	Drenas	1 h	24	Senzor	Analoge
14	Lluzhan	1 h	24	Senzor	Analoge
16	Vrogoli	1 h	24	Senzor	Analoge
17	Caralev	1 h	24	Senzor	Analoge
18	Milloshev	1 h	24	Senzor	Analoge
22	Domorovc	1 h	24	Senzor	Analoge
24	Kaqanik	1 h	24	Senzor	Analoge
25	Brod	1 h	24	Senzor	Analoge
27	Mlike	1 h	24	Senzor	Analoge

Po ashtu në çdo njërin prej këtyre profileve hidrometrike, janë bërë matje gjeodezike, në bazë të së cilave janë përcaktuar dhe janë paraqitë në formë grafike ( shih grafikun 1.) nivelet kritike të ujrave në lumenjë, që nënkupton nivelin në të cilin lumi del nga shtrati i tij dhe fillone faza e vershimeve.

<sup>1</sup> *General Packet Radio Service (GPRS) – Transferimi i të dhënave, në serverin qendrorë në Prishtinë, përmes sistemit të MODEMIT me sim kartel, i cili është nga operatorit telefonik “Vala.*

**Grafiku 1.Shembull: Profili hidrometrik në lumin Ibri stacioni Leposaviq**



Në rastë të arritjes së nivelit kritik (përcaktuar nga ekspertete e IHMK) të ujrave , përmes sistemit të komunikimit me stacionet hidrometrike, automatikisht ky sistem dërgon SMS në celularët e ekspertëve të IHMK , kështu që ekspertet paraprakisht marrin informacioni për arritjen e niveleve kritike dhe vlerojne tendencen apo mundësin e vërshimeve në ato profile lumore dhe përgatitet paralajmërimi i mundësisë së vërshimeve për lokacionet e monitoruara.

Nivelet mesatare, minimale dhe maksimale të ujrave të regjistruara në rrjetin e stacioneve hidrometrike të Kosovës gjatë periudhës 01 korrik – 30 shtatorë të vitit 2016, janë dhënë në tabelën në vazhdim (tab.2).

Nga të dhënat e tabelës 2, vërejmë se të tre muajt karakterizohen me nivele mesatare, të cilat janë në kondita normale duke i krahasuar ato me periudhën e viteve paraprake, dhe nuk ka devijim të theksuar edhe nga vlerat mesatare shumëvjeçare.

Niveli mesatarë i **Drinit të Bardhë në Gjonaj** gjatë kësaj periudhe ka qen 202 cm, ai maksimal 478 cm dhe është paraqitur më: 07.07.2016, ndërsa niveli minimal prej 143 cm, është paraqitur 06.08.2016.

Në lumin **Ibri** stacioni hidrometrik në Leposaviq, niveli mesatarë gjatë këtyre muajve ka qen 145 cm, ai më i larti 184 cm i regjistruar më 26.07.2016, ndërsa niveli minimal prej 128 cm, është regjistruar 14.07.201

**Tabela 2 Nivelet mesatare, maksimale dhe minimale (Cm), për periudhën VII—VIII – IX - 2016<sup>2</sup>**

Nr.	Station	Lumi	Max	Min	Mes	Max_aps	Min_aps	data_max	data_min
1	Berkove	Istog	0.96	0.79	0.86	1.01	0.72	03.07.2016	27.07.2016
2	Drelaj	Bistrica Pejës	1.16	0.31	0.46	1.31	0.22	07.09.2016	29.08.2016
3	Gryke	Bistrica Pejës	1.09	0.53	0.60	1.32	0.52	07.09.2016	30.07.2016
4	Klinë	Klinë	0.76	0.50	0.55	0.89	0.49	09.08.2016	07.09.2016
5	Këpuz	Mirushë	0.66	0.56	0.58	0.67	0.55	09.08.2016	13.07.2016
6	Deqan	Bistrica Deqanit	0.93	0.27	0.40	1.28	0.26	07.09.2016	25.09.2016
7	Kepuz	Drini Bardhë	2.05	0.68	0.91	2.19	0.67	08.09.2016	02.08.2016
8	Gjakove	Ereniku	0.85	0.28	0.43	0.93	0.25	07.09.2016	03.08.2016
9	Piran	Toplluhë	1.16	0.82	0.89	1.54	0.81	29.07.2016	05.09.2016
10	Gjonaj	Drini Bardhë	4.78	1.43	2.03	4.88	1.43	07.07.2016	06.08.2016
11	Prizren	Bistrica Prizrenit	0.74	0.42	0.55	0.93	0.41	07.09.2016	03.09.2016
12	Drenas	Drenicë	1.47	0.86	0.94	1.69	0.85	07.08.2016	14.07.2016
13	Lluzhan	Llapë	1.18	0.56	0.82	1.44	0.55	08.08.2016	10.07.2016
14	Nedakocv	Sitnicë	1.66	1.31	1.43	1.70	1.30	09.08.2016	13.07.2016
15	Vrogoli	Sitnicë	itnicë	0.43	0.48	0.62	0.42	09.08.2016	15.07.2016
16	Caralev	Caralevë	0.54	0.14	0.25	1.62	0.12	06.08.2016	25.07.2016
17	Milloshev	Llapë	2.01	0.93	1.32	2.52	0.91	08.08.2016	13.07.2016
18	Leposaviq	Ibër	1.84	1.28	1.45	1.93	1.23	26.07.2016	14.07.2016
19	Konqul	Morava Binçës	2.57	1.95	2.09	2.86	1.94	16.07.2016	01.09.2016
20	Viti	Morava Binçës	0.69	0.44	0.55	0.85	0.37	16.07.2016	29.09.2016
21	Domorovc	Kriva Reka	0.70	0.44	0.55	0.85	0.37	16.07.2016	29.09.2016
22	Kaqanik	Nerodime	0.53	0.30	0.35	0.61	0.29	02.07.2016	30.09.2016
23	Brod	Lepenc	1.06	0.53	0.64	1.22	0.50	06.09.2016	23.07.2016
24	Hani Elezit	Lepenc	1.05	0.62	0.70	1.39	0.61	07.09.2016	31.07.2016
25	Mlike	Brod	0.93	0.54	0.63	1.11	0.37	07.09.2016	03.09.2016

Ndërsa në lumin **Sitnica** në Nedakoc, niveli mesatarë ka qenë 143 cm, ai maksimal 166 cm, i cili ka arritur më 09.08.2016, dhe minimal prej 131 cm më 13.07.2016.


Në lumin **Morava e Binçës** stacioni Konçul, niveli mesatarë ka qenë 209 cm, ai maksimal 257 (16.07.2016), ndërsa minimal 195 cm (01.09.2016).

Ndërsa në lumin **Lepenc**, niveli mesatarë gjatë kësaj periudhe ka qenë 701 cm, ai maksimal 105 cm (07.09.2016) dhe niveli minimal është regjistruar më 31.07.2016 dhe ka pasur vlerën 62 cm.

Kjo periudhë karakterizohet me nivelet më të ulëta, sidomos muajt korrik – gusht, në të cilat njëherit paraqiten edhe nivelet minimale gjatë vitit (shih graf.2).

<sup>2</sup> H\_min\_AP dhe h\_max\_AP, parapet nivelin më të lartë të regjistruar gjatë periudhës referuese (VII-VIII - IX)


**Grafiku 2. Nivelet mesatare – maksimale dhe minimale VII – VIII –IX. 2016**



Gjatë fazës me nivele të ulëta, lumi kryesisht ushqehet nga ujërat nëntokësorë, kjo zakonisht vjen pas fazës me nivele të larta dhe përsëritet periodikisht.

Gjatë kësaj periudhe tremujore, nivele mesatare më të qëndrueshme kanë pasur lumenjtë: Bistrica e Deçanit, Ereniku, Toplluha, Drini Bardhë, Bistrica Prizrenit, Llapi, Sitnica,, ndërsa lëkundje më të theksuara edhe pse në masë të vogël kanë treguar lumenjtë: Bistrica Pejës, Lumi Istogut, Lumi Brodit etj, e cila arsyetohet me karakterin e tyre malorë, dhe konditave të ndryshme natyrore dhe klimatike (shih.graf.3).

**Grafiku 3. Nivelet mesatare dhe qëndrueshmëria e tyre (VII – VIII – IX. 2016)**





## GJENDJA METEOROLOGJIKE DHE KLIMATOLOGJIKE NE TREMUJORIN E TRETË

Gjendja meteorologjike dhe klimatologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes rrjetit të monitorimit meteorologjik dhe rrjetit për monitorimit e reshjeve (shih hartën 2).

Rrjeti meteorologjik është një numër i integruar i stacioneve matëse i shpërndarë në gjithë teritorin e Kosovës ku kryhen matje kualitative dhe të koordinuara mbi specifikat e lokacioneve. Arkivimi i të dhënave meteorologjike bëhet në softuerin qendror (MCH) të IHMK, përmes të cilit bëhet edhe përpunimi i të dhënave.

Analiza e të dhënave të regjistruara në stacionet meteorologjike gjatë periudhës për të cilën i referohemi në këtë buletin na bënë të kuptojmë se çfarë e karakterizon periudhën Korrik-Shtator 2016.

**Temperatura e ajrit**- karakterizohet me vlerën e temperaturës mesatare mujore, mesatare mujore minimale, dhe mesatare mujore të temperaturës maksimale si dhe me numrin e ditëve me vlerën e temperaturës mbi ose nën pragun e përcaktuar (varësisht nga sezoni dhe klima karakteristike).

Në vazhdim janë dhënë grafikonet e temperaturave karakteristike të ajrit (grafikoni 3 dhe 4) për stacionet kryesore klimatologjike, përfaqësuese të regjionit të rrafshit të Kosovës/pellgut të Ibrit-stc. në Prishtinë , rrafshit të Dukagjinit/Pellgut të Drinit të bardhë-stac. në Pejë, Pellgut të Lepencit-stac. në Ferizaj dhe pellgut të Ibrit, stacioni meteorologjik në Mitrovicë


Nga analiza e grafikoni 3 vërehet se periudha 01 Korrik – 30 Shtator 2016 është karakterizuar me vlera më të larta të temperaturës mesatare mujore krahasuar me temperaturat mesatare mujore të të njëjtës periudhë gjatë viteve 1960/1990.

Temperatura minimale gjatë periudhës 01 Korrik-30 shtator 2016 është regjistruar gjatë muajit shtator në stacionin e Ferizajit dhe arrinë vlerën në 2°C, ndërsa temperatura maksimale dhe




*Harta2. Rrjeti i stacioneve meteorologjike dhe të reshjeve*

karakteristike është regjistruar gjatë muajit gushtë në stacionin meteorologjik në Prishtinë dhe arrin vlerën në 34.8 °C, shih grafikonin 4.




Grafiku 3. Temperatura mesatare mujore në stacionet meteorologjike



Grafiku 4. Temperatura minimale dhe maksimale të ajrit pwr periudhen korrik - gusht

**Numri i ditëve me temperatura 30 °C** – periudha për të cilën jemi referuar në këtë buletin karakterizohet edhe me numrin e ditëve me temperatura 30 °C, ku gjatë muajit korrik kanë qenë 17 ditë me temperaturë 30 °C në Prishtinë , 16 ditë në Pejë , 15 ditë në Mitrovicë dhe 11 ditë në Ferizajë. Ndërsa muajit shtatorë nuk është regjistruar asnjë ditë me temperaturë 30 °C shih graf. 5.

**Numri i ditëve me temperatura 10 °C** - Gjatë kësaj periudhe numri i ditëve me temperature 10 °C ishte : në Prishtinë 10 ditë, Pejë 15 ditë, Ferizaj 14 ditë dhe Mitrovicë 12 ditë.



Grafiku5. Numri i ditëve me temperatura  $30^{\circ}\text{C}$  të regjistruara në stacionet klimatologjike

**Numri i orëve me diell (insolacioni)** - Ne periudhën monitoruese 01korrik-30 shtator), janë regjistruar gjithësejt 654.8 h me diell në Prishtinë dhe 778.6 h në Ferizaj.

**Shpejtësia e erës dhe drejtimi dominues** - Shpejtësia e erës është specifike e territoreve të caktuar meqë për shkakë të orografisë që ka vendi ynë dhe më konkretisht vargmaleve që e rrethojnë territorin tone , shpejtësia e erës dhe drejtimi dominues ndryshon shumë nga vendi në vend. Shpejtësia më e madhe është regjistruar në Ferizaj 16.4m/s nga drejtimi i veriperendimit dhe verilindjes, në Prishtinë shpejtësia më e lartë ishte 10.2m/s nga drejtimi i verilindjes, ndërsa në Pejë ishte shpejtësia më e vogël krahasuar me këto dy stacione me vetëm 4m/s në muajin korrik (zone urbane)

**Sasia e reshjeve dhe numri i diteve me reshje shiu-** Për dallim nga tremuori paraprak ku sasi më e lartë e reshjeve ishte regjistruar në Ferizaj , gjatë këtijë tremujori sasia më e lartë është regjistruar në Prishtinë dhe ka arritë vlerën në 259.5 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ), pastaj në Pejë 229.7 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) , në Ferizaj 211.7 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) dhe në Mitrovicë 184.2 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ).Ky tremujore karakterizohet me reshje të shumta shiu e veqanërisht gjatë muajit gushtë ku Prishtina kishte regjistruar 115.2 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) reshje shiu, Peja 54 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) , Ferizaj 51.1 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) dhe Mitrovica 54.6 ( $\text{L}/\text{m}^2$ ) .

Sipas numri të ditëve të regjistruar me reshje shiu gjatë muajit gusht ishte kjo gjendje: Prishtina dominon me 10 ditë , Peja me 8, Ferizaj me 6 dhe Mitrovicë 6 ditë reshje shiu. Ndërsa numri i përgjithshëm i ditëve me reshje shiu për tremujorin e tretë të vitit 2016 ishte: Prishtinë 25 ditë, Pejë 24 , Ferizaj 18 dhe Mitrovica 17 ditë.

Sipas shpërndarjes hapsinore, reshje më të larta ne këte periudhe ishin në qendër të Kosovës, kurse duke shkuar kahë perendimi , jugu dhe juglindja sasia e reshjeve ishte më e ulët.Ndërsa sipas shpërndarjes në përqindje të sasisë së reshjeve për periudhen 01Korrik-30 shtator reshjet shkonin në kategorinë e normales dhe vende vende te lagësht (mbi normalen).Ky tremujorë është karakterizuar edhe me reshje breshëri me intensitet të lartë të regjistruara me 02 korrik.

# DUKURIT EKSTREME

**PARAQITJA E THATËSIRAVE NË KOSOVË- INDEKSI STANDARD I PRECIPITIMIT(RESHJEVE)-SPI**

Situata e thatësirav në lidhje me akumulimin e reshjeve , paraqitet nga Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI). Llogaritja e SPI është e bazuar në shpërndarjen e reshjeve mbi periudha të gjata kohore 30 vjet , ne këtë rastë janë përdorur mesataret afatgjate (1926/1949-2016).

SPI mund të llogaritet në shkallë të ndryshme kohore te cilat pasqyrojnë ndikimin e thatësirës mbi disponueshmërinë e burimeve ujore.

Te dhënat për reshjet e regjistruara për një periudhë të gjatë kohore mundësonë një shpërndarje probabiliteti, e cila është normalizuar më pas në mënyrë që mesatarja SPI për çdo vend dhe periudhë kohore është zero. Vlerat e SPI mbi zero tregojnë periudha me lagështirë dhe vlerat nën zero tregojnë periudha të thata.

Në vazhdim janë paraqitë tabelat e SPI për regjionin e rrafshit të Kosovës/pellgu i Ibrit- stac.në Prishtinë, regjionin e Dukagjinit/pellgu i Drinit të Bardhë- stac.në Pejë dhe pellgun e Lepencit- stac. në Ferizaj.

tabela.2. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Prishtinë

Tabela.3. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Ferizaj

Tabela.4. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) për Pejë


Tabelat e lartëshënuara pasqyrojnë Indeksin e standardizimit të reshjeve (SPI) për periudhën 01 korrik -30 shtator 2016 në tri regjionet e lartëpërmendura. Nga analiza e SPI vërehet se nuk është paraqitë dukuri e thatësirave në asnjërin nga regjionet e Kosovës, përkundrazi, indeksi i standardizimit të reshjeve (SPI) për tri regjionet , tregon se është paraqitë periudhë me lagështi ne përmasa të vlerave normale për Pejë dhe Ferizaj ndërsa në prishtinë tejkalonë vlerat e normales në suficit (lagështi të tepërt) dhe tregon rrezikun për vërshime.

## PARAQITJA E VËRSHIMEVE NË KOSOVË

Siq është përmend edhe më lartë kjo periudhë është karakterizuar me reshje shiu ne disa raste të shoquara edhe me reshje të breshërit.Si pasojë e reshjeve të shumta të shiut me të cilat ishte përfshirë vendi yne, duke filluan më datë 05/09/2016, e të cilat vazhduan edhe gjatë 06, 07 dhe 08 shtator 2016 me intensitet me të lartë gjatë datës 06/09/2016, ndikuan që edhe rrjedhat lumore të dalin nga shtretërit e tyre dhe të shkaktojnë vërshime në disa pjesë të Kosovës.

Zonat të cilat u preken më tepër nga vërshimet, ishin rrjedha e mesme dhe e poshtme e Drinit të Bardhë me degët Ereniku, Bistrica e Deçanit, Bistrica e Pejës, lumi Istogut pastaj rrjedha e mesme dhe e poshtme e lumit Ibri, Lepenci, Nerodimja etj.

***Zonat ku rrjedhat ujore kan dalur prej shtretërve të tyre duke shkaktuar vërshime***



## **BULETINI HIDRO-KLIMATOLOGJIK- TREMUJORI I TRETË 2016, Nr.3**

### **Publikuar nga:**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës  
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

**Buletini Hidro-Klimatologjik - tremujori i tretë 2016, nr.3-** Është përgatitur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës .

### **Përgatitja e buletinit është realizuar nga:**

**Ing.e dipl./Msc. Letafete LATIFI**, *Drjetore e IHMK;*  
**Dr.sci. Bashkim KASTRATI**, *Hidrolog i lartë ne IHMK;*  
**Msc. Besim ALIU**, *Meteorolog në IHMK, stc.në Ferizaj.*

### **Kontribues në përgatitjen e buletinit janë zyrtarët e hidrologjisë dhe meteorologjisë:**

**Xhevahire Puraj**, *Hidrologe;*  
**Ing i dipl./Msc. Hasan Hasani**, *Hidrolog i lartë;*  
**Faton Sopi**, *Administrator në databazë;*  
**Beqir Gashi** , *Meteorolog, stac. Në Prishtinë*  
**Bardhyl Ahmetxhekaj**,*Meteorolog,stc.në Pejë*  
**Illir Topalli**, *Meteorolog, stc. në Mitrovicë*